



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:055024

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06162006

KPPP.nr. 360/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Bill Klinton”, p.n., kundër debitorit N.T.P “Rita”, me seli në Podujevë, rr. “Skëndërbeu”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 2465/23 të datës 02.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 16.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.P “Rita”, me seli në Podujevë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 2465/23, i datës 02.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Flamur Bogaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A., me datë 02.11.2023 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 2465/23 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist – Kartelës së konsumatorit me shifrën 114131, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 869.64 EUR (tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e katër cent), me kamatë ligjore prej 4.3 % nga data e lejimit të përbarimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit me arsyetim se kërkesa e kreditorit është parashkruar sipas nenit 360 të LMD-së, si dhe palët nuk ka

lidhur ndonjë marrëveshje për riprogramim të borxhit që do të shkaktonte ndërprerjen e parashkrimit. Më tej, ka theksuar se pagesat e kohë pas kohëshme që i ka realizuar nuk nënkuptojnë pohimin e borxhit për vet faktin se i njëjti me prapësim po e kundërshton borxhin, e që nuk nënkupton ndërprerjen e parashkrimit. Ka shtuar se kreditori asnjëherë nuk ka dorëzuar faturat tek debitori dhe as nuk ka paralajmëruar të njëjtin në lidhje me afatet e pagesës. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditore në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se nuk i ka mbështetur në prova. Ka shtuar se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist është dokument i besueshëm dhe është i përshtatshëm për përmbartim. Ndërsa, sa i përket pretendimeve për parashkrim, borxhi i kërkuar është për vitet 2021-2023 e që gjatë të njëjtës periudhë debitori ka realizuar pagesa, duke ndërprerë parashkrimin. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të shfuqizohet, për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumën dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist – Kartela e konsumatorit me shifrën 114131 mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së, ngase në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që në ekstraktin- kartelën e konsumatorit, në pjesën e sipërme të tij, borxhi në shumën prej 869.64 EUR rezulton se është krijuar për periudhën

2017-2023, ndërsa ekstrakti në fjalë, përmban pasqyrën e faturave vetëm nga data 04.01.2018 e deri më datë 31.10.2023, por jo edhe faturat e grumbulluara për vitin 2017. Për më tepër, ekstrakti në fjalë, përmban si borxh të bartur shumë prej 466.65 EUR ndërsa propozimit për përmbarim, nuk i është bashkangjitur pjesa tjetër e faturave sipas ekstraktit nga të cilat vërtetohet periudha kohore brenda të cilës është krijuar edhe kjo pjesë e borxhit.

Në anën tjetër, në propozimin për përmbarim, kreditori ka specifikuar periudhën kohore nga data 31.10.2021 e deri me datë 31.10.2023 lidhur me borxhin në shumë prej 869.64 EUR, përkundër që në ekstraktin nga librat afarist, shuma e lartcekur figuron si borxh total i ekstraktit për tërë periudhën nga viti 2017 e deri në vitin 2023, andaj vlera e borxhit në emër të shërbimeve për bartjen e mbeturinave nuk mund të jetë i njëjtë për periudha të ndryshme kohore.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë objektin e detyrimit dhe kohën brenda të cilës detyrimi është krijuar, të meta këto që janë pasqyruar edhe në propozimin për përmbarim nga ana e kreditorit.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 71 par.1, nën-par.1.1 të LPP-së me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *“dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”* u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi, meqenëse dokumenti ekstrakt-kartelë e konsumatorit, nuk mungesë të elementeve të detyrueshme të tij, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 360/24, datë 16.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.